

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

**ÇËSHTJA MELI DHE SWINKELS FAMILY BREWERS N.V. KUNDËR
SHQIPËRISË**

(kërkesat nr. 41373/21 dhe 48801/21)

VENDIM

Neni 6 § 1 (aspekti civil) • E drejta për t'ju drejtuar gjykatës • Rrëzimi i ankimeve kushtetuese përkatëse të kërkuar si rezultat ose i votave të ndara në mënyrë të barabartë ose i mosarritjes së shumicës së kërkuar prej pesë gjyqtarësh për gjetjen e një shkeljeje kushtetuese • As votat e ndara në mënyrë të barabartë as kërkesa për shumicë të cilësuar nuk përbën *per se* shkelje të nenit 6 • Dispozita përkatëse ligjore, të ndryshuara pas dhe në përgjigje të vendimit gjyqësor *Marini kundër Shqipërisë*, mjaftueshëm të qarta në lidhje me rezultatin e ankimeve që rezultojnë në vota të ndara në mënyrë të barabartë ose çdo votim ku nuk formohet shumica prej pesë gjyqtarësh • Vlerësimi i duhur i themelit dhe vendimmarrja përfundimtare për pretendimet e kërkuarve • Sigurimi i së drejtës për t'ju drejtuar Gjykatës Kushtetuese

Neni 6 § 1 (aspekti civil) • Seancë dëgjimore e drejtë • Mungesa e arsytimit adekuat • Mosdhënia nga Gjykata Kushtetuese e arsyeve dhe shkaqeve themelore për rrëzimin e pretendimeve të kërkuarve

Përgatitur nga Zyra e Kancelarit. Nuk është i detyrueshëm për Gjykatën.

STRASBURG

16 korrik 2024

*Ky vendim është bërë përfundimtar sipas nenit 4, paragrafi 2 të Konventës.
Mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktorial.*

Në çështjen Meli dhe Swinkels Family Brewers N.V. kundër Shqipërisë,
Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si Komitet i përbërë nga:

Pere Pastor Vilanova, *kryetar*,
Jolien Schukking,
Darian Pavli,
Peeter Roosma,
Andreas Zünd,
Oddný Mjöll Arnardóttir,
Diana Kovatcheva, *gjyqtarë*,
dhe Milan Blaško, *kancelar seksioni*,
duke pasur parasysh:

kërkesat (nr. 41373/21 dhe 48801/21) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituara në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (Konventa) nga z. Astrit Meli, shtetas shqiptar (kërkuar) dhe nga Swinkels Family Brewers N.V., një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit holandez (shoqëria kërkuar), më 30 korrik 2021 dhe 1 tetor 2021 përkatësisht;

vendimin për të njoftuar Qeverinë e Shqipërisë (Qeveria) për ankimet, në lidhje me të drejtën për t'ju drejtuar Gjykatës Kushtetuese dhe që mosdhënia nga gjykata e arsyeve për rrëzimin e ankimeve të kërkuarve, në lidhje me mosdhënien e arsytimit adekuat të gjykatave më të ulëta; dhe,

në lidhje me kërkesën nr. 41373/21, në lidhje me kohëzgjatjen e tepruar të proceseve gjyqësore në Gjykatën Kushtetuese dhe barazinë e armëve;

vendimet për të shpallur të papranueshme pjesët e mbetura të kërkesave;

vendimin e qeverisë holandeze për të mos përfituar nga e drejta për të ndërhyrë në procese gjyqësore (neni 36 § 1 i Konventës);

parashtrimet e palëve;

Pas diskutimit me dyer të mbyllura, më 25 qershor 2024,

mori vendimin e mëposhtëm, i cili miratohet po në atë datë:

HYRJE

1. Çështja ka të bëjë me ankimet e kërkuessve për mohimin e aksesit në Gjykatën Kushtetuese, për mosdhënien e vendimeve të arsyetuara nga ajo gjykatë për shkak të rrëzimit të ankimeve kushtetuese të kërkuessve sepse nuk është arritur shumica e ligjshme prej pesë gjyqtarësh dhe për mungesën e arsytimit të vendimeve të gjykatave më të ulëta. Çështja e kërkuessit ka të bëjë edhe me barazinë e armëve dhe kohëzgjatjen e procesit gjyqësor përpara Gjykatës Kushtetuese.

FAKTET

RRETHANAT E ÇËSHTJES

2. Kërkuessi ka lindur në vitin 1959 dhe jeton në Tiranë. Kërkuessi u përfaqësua nga z. F. Caka, avokat i licencuar në Tiranë.

3. Shoqëria kërkuessë është shoqëri me përgjegjësi të kufizuara që u themelua sipas legjislacionit holandez në vitin 1930 dhe ka selinë e regjistruar në Lieshout. Është e angazhuar në prodhimin dhe tregtimin e pijeve alkoolike dhe joalkoolike. Në vitin 2019 e ndryshoi emrin nga Bavaria N.V. në Swinkels Family Brewers N.V. dhe u përfaqësua nga z. K. Loloçi, avokat i licencuar në Tiranë.

4. Qeveria u përfaqësua nga agjenti i saj në atë kohë, z. O. Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit.

5. Faktet e çështjes, siç u parastruan nga palët, mund të përmbliidhen si më poshtë.

A. Kërkesa nr. 41373/21: Meli kundër Shqipërisë

6. Më 22 gusht 2007, kërkuessi ngriti padi civile në Gjykatën e Rrethit Vlorë kundër disa palëve private dhe Agjencisë për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave, ku kërkoi titullin e pronësisë për një tokë e cila i ishte kthyer tashmë palëve të treta në procese gjyqësore për kthimin.

7. Në një seancë të mbajtur më 25 nëntor 2009, një eksperte e caktuar nga gjykata paraqiti raportin e saj. Kërkuessi dhe avokati i tij mungonin në atë seancë dëgjimore. Palët i drejtuan pyetje të mëtejshme ekspertit, të cilat morën përgjigje me shkrim në seancën e radhës. As kërkuessi as avokati i tij nuk ngriti ndonjë pretendim për aftësitë profesionale të ekspertes apo për konkluzionet e raportit, në lidhje me pretendimin e kërkuessit për pronën.

8. Më 16 mars 2010, Gjykata e Rrethit Vlorë, duke pasur parasysh argumentet e palëve dhe raportin e ekspertes, refuzoi pretendimin e kërkuessit për pronësinë mbi parcelë, me gjetjen që dokumentet që ai kishte dhënë ishin të pa mjaftueshme për të provuar pronësinë e tij. Ajo gjykatë u shpreh që dokumentit arkivor të paraqitur nga kërkuessi i mungonte harta shoqëruese që tregon vendndodhjen e pronës së paraardhësit të tij. Megjithatë, ajo pranoi pretendimin e një pale të tretë për pronësinë në bazë të dokumenteve provuese.

9. Kërkuessi e ankimoi atë vendim. Më 23 prill 2012, vendimi u la në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë, e cila mbështeti arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë që provat e dhëna nga kërkuessi nuk provuan të drejtën e tij të pronësisë për tokën. Ajo gjykatë, ashtu si Gjykata e Rrethit, u shpreh që mungesa e hartave përkatëse që shoqërojnë dokumentet arkivore e bënë të pamundur identifikimin e vendndodhjes së saktë të tokës që i përkiste paraardhësit të kërkuessit, kështu që nuk mund të përcaktohej që toka objekt i proceseve gjyqësore ishte toka e cila i ishte shpronësuar atij. Nga ana tjetër, pala e trete ishte në gjendje të siguronte jo vetëm dokumente arkivore për gjykatën, por edhe hartat dhe dokumentet në lidhje me parcelat kufitare që mund të provonin të drejtën e tij të pronësisë mbi tokën. Gjykata e Apelit Vlorë vlerësoi se raporti i ekspertes ishte përgatitur në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore dhe se ekspertja ishte e kualifikuar për ta hartuar atë. Ajo rrëzoi disa ankime në lidhje me raportin që kërkuessi kishte ngritur në ankimimin e tij. Kërkuessi nuk

paraqiti ndonjë provë të re apo raport alternativ në Gjykatën e Apelit Vlorë për të mbështetur kundërshtimet e tij për raportin origjinal dhe kërkesën e tij për një raport të ri.

10. Një ankimim vijues për pikat e ligjit i ngritur nga kërkuesi u rrëzua nga Gjykata e Lartë më 13 qershor 2017.

11. Më 13 tetor 2017, kërkuesi depozitoi një ankim kushtetues. Më 12 janar 2018, një trup gjykues i përbërë nga tre gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese vendosi që çështja të dëgjohej me dyer të mbyllura në seancën plenare të gjykatës.

12. Më 9 mars 2021, e mbledhur në seancë me trup gjykues të përbërë nga gjashtë gjyqtarë (sepse në atë kohë kishte tre vende vakante në trupin gjykues me nëntë gjyqtarë), Gjykata Kushtetuese u nda tre me tre në lidhje me ankimin e kërkuetit për një shkelje të pretenduar të barazisë së armëve, dhe katër me dy në favor të rrëzimit të ankimit të tij për shkelje të së drejtës për një vendim gjyqësor të arsyetuar. Si rezultat, ankimet u rrëzuan sepse gjykata nuk arriti shumicën prej pesë gjyqtarësh për themelin e tyre të kërkuar me ligj.

13. Arsyetimi i vendimit përbëhej vetëm nga një përshkrim i shkurtër i parimeve ligjore përkatëse dhe rezultatet e votimit dhe rezultatit e tij. Në shënimin fundor jepet ndarja e votimit sipas çdo vote individuale të çdo gjyqtari. Sipas nenit 73(4) të ligjit për Gjykatën Kushtetuese (shihni paragrafin 29 më poshtë), ai vendim ishte përfundimtar.

B. Kërkesa nr. 48801/21: Swinkels Family Brewers N.V. kundër Shqipërisë

14. Më 22 shkurt 2008, shoqëria kërkuuese regjistroi një markë tregtare për produktin e saj B-52, një pije energjike, në Zyrën e Beneluksit për Pronësinë Intelektuale dhe më 24 qershor 2008 mori regjistrimin ndërkombëtar të markës tregtare. Më 12 shkurt 2009, Organizata Ndërkombëtare e Pronësisë Intelektuale e shtriu mbrojtjen e markës tregtare në Shqipëri.

15. Në vijim, një shoqëri shqiptare, A. pretendoi se ajo tashmë e kishte atë markë tregtare në Shqipëri dhe nisi një proces civil kundër shoqërisë kërkuuese për të kërkuar anulimin e markës tregtare të shoqërisë kërkuuese në Shqipëri. Më 26 dhjetor 2012, Gjykata e Rrethit Tiranë e pranoi atë padi. Shoqëria kërkuuese e ankimoi atë vendim, por ai u la në fuqi më 5 shtator 2013 dhe më 9 maj 2016 nga Gjykata e Apelit Tiranë dhe Gjykata e Lartë, përkatësisht.

16. Ndërkohë, në vijim të kërkesës së shoqërisë kërkuuese, Drejtoria e Përgjithshme e Markave dhe Patentave (Drejtoria), e shtriu mbrojtjen e markës tregtare për të përfshirë Shqipërinë.

17. Shoqëria A. depozitoi një ankesë në Drejtorin për regjistrimin nga kjo e fundit të markës tregtare të shoqërisë kërkuuese në Shqipëri; ankesa u rrëzua dhe më pas shoqëria A depozitoi padi civile në Gjykatën e Rrethit Tiranë. Më 24 qershor 2013, gjykata e pranoi pjesërisht pretendimin dhe shfuqizoi regjistrimin e markës tregtare të shoqërisë kërkuuese në Shqipëri për pijen në fjalë, duke u shprehur se marka tregtare e shoqërisë A. në Shqipëri për pijen ishte regjistruar përpara asaj të shoqërisë kërkuuese.

18. Shoqëria kërkuuese bëri ankim kundër atij vendimi, mes të tjerash, me pretendimin që paditësi kishte vepruar në keqbesim kur kishte regjistruar markën tregtare në Shqipëri sepse e kishte ditur që pija ishte prodhuar nga shoqëria kërkuuese dhe, gjithashtu, ishte tregtuar në Shqipëri në periudhën 2006–2008. Më 6 maj 2014 dhe më 5 tetor 2017, vendimi i Gjykatës së Rrethit u la në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë dhe Gjykata e Lartë përkatësisht. Më 5 shkurt 2018, shoqëria kërkuuese paraqiti një ankim kushtetues kundër atyre vendimeve.

19. Më 17 janar 2020, një trup gjykues me tre gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese referoi ankimin e shoqërisë kërkuuese në seancën plenare të gjykatës (shihni paragrafin 25 më poshtë). Më 29 janar 2020, u vendos që çështja të dëgjohej me dyer të mbyllura nga seanca plenare e gjykatës.

20. Më 11 mars 2021, Gjykata Kushtetuese, e mbledhur në seancë plenare me shtatë gjyqtarë (në atë kohë kishte dy vende vakante), rrëzoi ankimin e shoqërisë kërkuuese me votim katër me tre kundër pranimit të ankimit. Ankimi i shoqërisë kërkuuese kishte të bënte me mungesën e arsyetimit adekuat të vendimeve të Gjykatës së Rrethit dhe Gjykatës së Apelit. Arsyetimi i Gjykatës Kushtetuese u kufizua në deklarin e faktit se ajo nuk mund të arrinte shumicën e kërkuar me ligj prej pesë gjyqtarësh për çështjen e ngritur. Në shënimin fundor jepet ndarja e votimit sipas çdo

vote individuale të çdo gjyqtari. Sipas nenit 73(4) të ligjit për Gjykatën Kushtetuese (*shihni paragrafin 29 më poshtë*), ai vendim ishte përfundimtar.

C. Reformat e Sistemit Shqiptar të Drejtësisë

21. Në vitin 2016, Shqipëria filloi reformën e gjerë në sistemin e saj të drejtësisë, e cila rezultoi me ndryshime në Kushtetutë dhe miratimin e një sërë ligjesh thelbësore që lidhen, ndër të tjera, me rivlerësimin e të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve efektivë (ndryshe i njohur si procesi i vetingut të gjyqtarëve dhe prokurorëve), riorganizimin e gjyqësorit, përfshirë Gjykatën Kushtetuese dhe krijimin e organeve të reja qeverisëse të sistemit të drejtësisë (shihni Xhoxhaj kundër Shqipërisë, nr. 15227/19, §§ 4–7, 9 shkurt 2021). Për shkak të dorëheqjeve dhe shkarkimit të një numri gjyqtarësh në kuadër të procesit të vetingut, Gjykatës Kushtetuese i mungonte kuorumi vendimmarrës dhe për këtë arsye nuk mund të merrte vendime themeli, nga data 23 mars 2018 deri më 23 dhjetor 2020.

KUADRI LIGJOR PËRKATËS DHE PRAKTIKA

I. KUSHTETUTA

22. Pjesët përkatëse të Kushtetutës Shqiptare lexojnë si më poshtë:

Neni 131

“Gjykata Kushtetuese vendos për:

...

f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave, përveçse kur parashikohet ndryshe në Kushtetutë.”

Neni 133

“...

2. Gjykata Kushtetuese merr vendim përfundimtar me shumicën e të gjithë anëtarëve të saj, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj.”

II. LIGJI (PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN) E GJYKATËS KUSHTETUESE NR. 8577) I 10 SHKURTTIT 2000, I NDRYSHUAR ME LIGJIN NR. 99/2016

23. Ligji parashikon që Gjykata Kushtetuese zgjidh mosmarrëveshjet kushtetuese dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës (neni 2).

24. Gjykata Kushtetuese përbëhet nga nëntë anëtarë, të cilët emërohen nga Presidenti i Republikës, nga Kuvendi i Shqipërisë dhe nga Gjykata e Lartë (neni 7).

25. Vlerësimi paraprak i pranueshmërisë së ankimeve të depozituara nga individët bëhet nga trupi gjykues me tre gjyqtarë, përfshirë gjyqtarin relator. Nëse nuk arrihet unanimiteti, vendimi i kalon Mbledhjes së Gjyqtarëve (neni 31).

26. Gjykata vendos për themelin e kërkesave individuale në trup gjykues të plotë. Kuorumi i seancës plenare është dy të tretat e të gjithë gjyqtarëve ose gjashtë gjyqtarë (neni 32(1)).

27. Neni 71/c parashikon që proceset në Gjykatën Kushtetuese mund të rihapen nëse një gjykatë ndërkombëtare, juridiksioni i të cilës shtrihet në Republikën e Shqipërisë, konstaton se janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore të një personi “për shkak të një vendimi [të mëparshëm] të Gjykatës Kushtetuese”.

28. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese merren me shumicën e votave të të gjithë gjyqtarëve të saj dhe nuk lejohet abstenimi. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese “shpallet i arsyetuar” (neni 72(6)).

29. Neni 73(4) i ligjit, i cili u prezantua me ndryshimet e vitit 2016 dhe hyri në fuqi më 1 mars 2017, parashikon që: “kur nuk formohet shumica prej 5 gjyqtarësh”, kërkesa konsiderohet e rrëzuar përfundimisht. Ish neni 74 i cili parashikonte mundësinë e depozitimit të një ankimi të ri në këto raste, u shfuqizua.

30. Që nga 1 marsi 2017, neni i ri 71/ç ka parashikuar një mjet juridik në lidhje me kohëzgjatjen e procesit gjyqësor përpara Gjykatës Kushtetuese. Çdo palë në procesin gjyqësor përpara Gjykatës Kushtetuese mund të kërkojë kompensim të drejtë nga Gjykata Kushtetuese nëse ai ose ajo vlerëson se procesi gjyqësor ka zgjatur për shumë kohë. Që të paraqitet një kërkesë e tillë, procesi gjyqësor duhet të ketë zgjatur më shumë se një vit.

III. PRAKTIKA E FUNDIT E GJYKATËS KUSHTETUESE NË LIDHJE ME ARSYETIMIN E DHËNË KUR NUK ËSHTË ARRITUR SHUMICA E KËRKUAR

31. Në vendimet nr. 49 dhe nr. 52, të 16 dhe 18 tetorit 2023, përkatësisht, Gjykata Kushtetuese nuk arriti shumicën e kërkuar me pesë gjyqtarë as për pyetjen e pranueshmërisë as në lidhje me themelin e disa ankimeve të ngritura nga kërkuarit, dhe i rrëzoi ato kërkesa. Sipas nenit 73(4) të ligjit për Gjykatën Kushtetuese (shihni paragrafin 29 më poshtë), ato vendime ishin përfundimtare. Në të dyja çështjet, arsyetimi i gjykatës përmbante një përmbledhje të “qëndrimeve” kryesore për themelin, të shprehura në diskutime dhe një tregues të votave të çdo gjyqtari në mbështetje të çdo qëndrimi.

LEGJISLACIONI

I. BASHKIMI I KËRKESAVE

32. Duke pasur parasysh objektin e ngjashëm të kërkesave, Gjykata e gjen të përshtatshme t’i shqyrtojë ato së bashku në një vendim të vetëm gjyqësor sipas Rregullit 42 § 1 të Rregullores së Gjykatës.

II. SHKELJET E PRETENDUARA TË NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS

33. Kërkuarit u ankuan se rrëzimi i ankimeve të tyre kushtetuese për shkak se Gjykata Kushtetuese nuk arriti shumicën e kërkuar u mohoi atyre të drejtën për t’ju drejtuar asaj gjykate, në kundërshtim me paragrafin 1, neni 6 të Konventës. Sipas të njëjtit nen, ata u ankuan edhe për mungesën e arsyetimit në vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Në kërkesën nr. 41373/21, kërkuari u ankua më tej për kohëzgjatjen e procesit gjyqësor përpara Gjykatës Kushtetuese.

Pjesa përkatëse e paragrafit 1, neni 6 të Konventës lexon si më poshtë:

“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj.”.

A. Pranueshmëria

1. E drejta për t’ju drejtuar Gjykatës Kushtetuese dhe e drejta për një vendim gjyqësor të arsyetuar

a) Parashtrimet e palëve

34. Në lidhje me kërkesën nr. 48801/21, Qeveria pretendoi se shoqëria kërkuuese nuk kishte ngritur disa nga ankimet e saj sipas Konventës përpara gjykatave të brendshme. Megjithatë, ajo nuk dha ndonjë specifikë për ankimet të cilave i referohej.

35. Gjithashtu, Qeveria parashtrroi që ankimet e shoqërisë kërkuuese duhet të shpallen të papranueshme sepse ishin të pambështetura dhe sepse ishte abuzuar me të drejtën e ankimit individual. Ankimet ishin dëgjuar si duhej nga Gjykata Kushtetuese, e cila kishte dhënë tashmë një përgjigje përfundimtare.

36. Shoqëria kërkuuese pretendoi që nuk kishte prezantuar ndonjë fakt të njohur të pavërtetë ose deklaramë të rreme përpara Gjykatës ose përndryshe nuk kishte vepruar në ndonjë mënyrë që mund të konsiderohej si sjellje abuzive. Prandaj, i kërkoi Gjykatës që të rrëzojë kërkesën e Qeverisë për papranueshmëri bazuar në faktin që nuk kishin bërë asnjë referencë konkrete dhe as nuk kishin dhënë ndonjë provë specifike për ndonjë sjellje abuzive nga shoqëria kërkuuese.

b) Vlerësimi i Gjykatës

i. Shterimi i mjeteve juridike të brendshme

37. Në lidhje me parashtrimet e Qeverisë për shterimin e mjeteve juridike të brendshme, Gjykata thekson se ajo nuk ju referua ndonjë mjeti juridik specifik dhe prandaj nuk mund të vendosë në pikëpyetje shterimin e mjeteve juridike të brendshme nga shoqëria kërkuuese (krahasoni Molla Sali kundër Greqisë [DHM], nr. 20452/14, § 89, 19 dhjetor 2018, dhe Mocanu dhe të tjerët kundër Rumanisë [DHM], nr. 10865/09 dhe 2 të tjerë, § 225, GJEDNJ 2014 (ekstrakte)). Prandaj kundërshtimi i Qeverisë duhet të rrëzohet.

ii. Abuzimi me të drejtën për kërkesë

38. Për sa i përket pretendimit të Qeverisë që shoqëria kërkuuese kishte abuzuar me të drejtën e saj të kërkesës, parimet përkatëse janë përcaktuar, për shembull, në Gross kundër Zvicrës ([DHM], nr. 67810/10, § 28, GJEDNJ 2014). Në veçanti, Gjykata thekson se një kërkesë mund të refuzohet

si abuzive vetëm në rrethana të jashtëzakonshme, të tilla si, për shembull, nëse është bazuar me vetëdije në fakte të pavërteta (shihni, për shembull, Akdivar dhe të tjerët kundër Turqisë, 16 shtator 1996, §§ 53–54, Raportet e vendimeve 1996-IV, Varbanov kundër Bullgarisë nr. 31365/96, GJEDNJ 2000-X; dhe Popov kundër Moldavisë (nr.1) nr. 74153/01, § 49, 18 janar 2005).

Synimi i kërkuarit për të mashtruar Gjykatën duhet të provohet gjithmonë me siguri të mjaftueshme (shihni Gross, cituar më lart, § 28). Megjithatë, nuk ka asnjë tregues të tillë në rastin konkret dhe ky kundërshtim nga Qeveria gjithashtu duhet të refuzohet.

iii. Konkluzioni në lidhje me pranueshmërinë e ankimeve për të drejtën e kërkuarve për t'ju drejtuar Gjykatës Kushtetuese dhe arsyetimin e dhënë nga ajo gjykatë

39. Gjykata vlerëson se ankimet, në lidhje me të drejtën e kërkuarve për t'ju drejtuar Gjykatës Kushtetuese dhe mosdhënien e pretenduar nga kjo e fundit të arsyetimit adekuat në vendimet e saj në çështjet e kërkuarve, nuk janë as haptazi të pabazuara dhe as të papranueshme për ndonjë arsye tjetër të renditur në nenin 35 të Konventës. Prandaj, ato duhet të shpallen të pranueshme.

2. Kohëzgjatja e procesit gjyqësor përpara Gjykatës Kushtetuese

a) Parashtrimet e palëve

40. Në lidhje me kërkesën nr. 41373/21, Qeveria ftoi Gjykatën të rrëzojë ankimin e kërkuarit për tejkëmbimin e proceseve gjyqësore për shkak se ai nuk kishte shteruar mjetin e brendshëm juridik, të parashikuar në nenin 71/ç të ligjit për Gjykatën Kushtetuese për tejkëmbimin e procesit gjyqësor, gjë që do të bënte të mundur që ai të përshpejtonte procesin dhe/ose të kërkonte kompensim për tejkëmbimin e këtyre proceseve.

41. Kërkuari pretendoi se mjeti juridik në fjalë nuk ishte efektiv. Nga data 23 mars 2018, Gjykatës Kushtetuese i mungonte kuorumi për të vendosur për çfarëdo çështje, kështu që paraqitja e ankimit lidhur me tejkëmbimin e proceseve nuk kishte pasur asnjë mundësi suksesi dhe nuk mund ta adresonte ankimin e tij.

b) Vlerësimi i Gjykatës

42. Gjykata vlerëson se pretendimi që dorëzimi i një ankimi për tejkëmbimin e procesit gjyqësor në Gjykatën Kushtetuese nuk ishte një mjet juridik efektiv sepse Gjykata Kushtetuese nuk ishte funksionale në atë kohë, nuk mund të pranohet në këto rrethana. Mungesa e kuoromit ishte një situatë e përkohshme (shihni paragrafin 21 më sipër) dhe prandaj, çdo ankim i depozituar në gjykatë gjatë asaj periudhe do të shqyrtohej sapo Gjykata Kushtetuese të krijonte kuorumin e nevojshëm. Ndërsa kërkuari, arsyeshëm, mund të kishte vlerësuar që procesi gjyqësor nuk mund të përshpejtohej gjatë periudhës që Gjykata Kushtetuese ishte jo funksionale për shkak të mungesës së kuoromit, gjithsesi kërkuari mund të ndiqte një mjet kompensues sapo gjykata të krijonte kuorumin. Gjykata vlerëson se kërkuarit ju kërkua që t'i japë gjykatës mundësinë për të vendosur për ankimin e tij mbi kohëzgjatjen e procesit gjyqësor, sipas nenit 71/ç të ligjit për Gjykatën Kushtetuese (shihni paragrafin 30 më sipër, krahasoni *Fullani kundër Shqipërisë* (vendim), nr. 4586/18, § 77, 20 shtator 2022). Nëse nuk e bën këtë do të thotë që ankimin e tij në lidhje me kohëzgjatjen e procesit gjyqësor është i papranueshëm për mosshkrimin e mjeteve juridike të brendshme dhe duhet të refuzohet sipas nenit 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës.

B. Themeli

1. Parashtrimet e palëve

43. Kërkuari parashtroi që nuk kishte marrë një vendim përfundimtar nga Gjykata Kushtetuese për ankimet e tij mbi shkeljen e pretenduar të parimit të barazisë së armëve dhe mungesën e arsyetimit adekuat në vendimet e gjykatave më të ulëta. Gjithashtu, vendimi që rrëzoi ato ankime nuk përmbante ndonjë arsytim. I vetmi informacion i dhënë në vendim kishte të bënte me mënyrën se si votuan gjyqtarët.

44. Shoqëria kërkuuese u ankua që në çështjen e saj Gjykata Kushtetuese kishte miratuar një vendim për pranueshmërinë ose themelin dhe prandaj nuk kishte marrë një vendim përfundimtar për pretendimin e saj. Ajo pretendoi se duke refuzuar ankimet e saj për shkak se nuk ishte arritur shumica me pesë gjyqtarë, Gjykata Kushtetuese nuk i kishte dhënë shoqërisë kërkuuese ndonjë arsytim për vendimin, duke kufizuar kështu të drejtën e saj për vendimmarrjen e duhur për

pretendimet e saj civile. Vendimit i mungonte arsytimi edhe për mendimin e shumicës edhe për mendimin e pakicës.

45. Në lidhje me argumentin e Qeverisë që praktika e Gjykatës Kushtetuese në Shqipëri ishte e krahasueshme me sistemin e votave të barabarta të Gjykatës së Lartë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (Gjykata e Lartë e SHBA-ve), shoqëria kërkuese pretendoi se krahasimi ishte sipërfaqësor. Rregullimi ligjor për këto çështje në Gjykatën e Lartë të SHBA-ve ndryshonte ndjeshëm nga praktika gjyqësore e Gjykatës në këtë drejtim. Kërkesa për përsëritje të seancës dëgjimore mund të bëhet kundër çdo vendimi gjyqësor të Gjykatës së Lartë të SHBA-ve, dhe këto kërkesa ka më shumë të ngjarë që të pranohen në çështje ku refuzimi ka ndodhur për shkak të votave të barabarta. Gjithashtu, kërkesat e refuzuara për shkak të një Gjykate të Lartë të ndarë në mënyrë të barabartë, nuk kishin vlerë precedenti. Shoqëria kërkuese argumentoi se të dyja këto elemente nuk ishin në përputhje me qasjen e Gjykatës për parimin e sigurisë juridike.

46. Qeveria pretendoi se kërkuesit patën një seancë dëgjimore të drejtë në përputhje me nenin 6 § 1 të Konventës dhe se nuk kishte shkelje të së drejtës së kërkuesve për t'ju drejtuar Gjykatës Kushtetuese. Ajo parashittoi se pas çështjes *Marini kundër Shqipërisë* (nr. 3738/02, 18 dhjetor 2007), ku Gjykata konkludoi se refuzimi përkohësisht i çështjes përkatëse e kishte lënë kërkuesin pa një vendimarrje përfundimtare për padinë e tij civile, Shqipëria kishte ndërmarrë një reformë kushtetuese dhe ligjore për të trajtuar problemin.

47. Ndryshimet parashikonin që sa herë që Gjykata Kushtetuese nuk mund të arrinte shumicën me pesë gjyqtarë, ankimi do të refuzohej përfundimisht dhe në mënyrë definitive (shihni paragrafin 29 më sipër). E drejta e brendshme nuk pengoi mundësinë që çështjet të gjykoreshin nga një trup gjykues me më pak se nëntë gjyqtarë. Ndryshimet u pasqyruan në shfuqizimin e nenit 74 të ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe ndryshimet në nenet 72 dhe 73 (shihni paragrafët 28 dhe 29 më sipër). Prandaj, kërkuesit kishin marrë një vendim të qartë dhe përfundimtar të ankimeve të tyre, të cilat ishin rrëzuar bazuar në dispozitat përkatëse ligjore. Kërkuesit ishin informuar për qëndrimet dhe votat e gjyqtarëve.

48. Më tej, Qeveria pretendoi se pranueshmëria e ankimeve të kërkuesve ishte vlerësuar me anë të mekanizmit të filtrimit të Gjykatës Kushtetuese (trup gjykues me tre gjyqtarë) (shihni paragrafët 11, 19 dhe 25 më sipër). Në çdo çështje, trupi gjykues i filtrimit kishte marrë një vendim që shpjegonte faktet e çështjes dhe arsytet për pranueshmërinë e ankimit. Pasi u dërgua në seancën plenare për diskutim të plotë për themelin, çështjet u rrëzuan, bazuar në dispozitat përkatëse ligjore, për shkak të mosarritjes së shumicës së kërkuar.

49. Në lidhje me ankimin që vendimet e Gjykatës Kushtetuese nuk kanë arsytim, Qeveria pretendoi se të gjitha ankimet e kërkuesve ishin vlerësuar veçmas dhe më pas rrëzuar përfundimisht nga Gjykata Kushtetuese. Vendimet kishin bërë të qartë qëndrimin e çdo gjyqtari në të dyja çështjet. Sistemi i përdorur nga Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë ishte i krahasueshëm me atë të përdorur nga Gjykata e Lartë e SHBA-ve, ku një votë e barabartë rezultoi në rrëzimin e ankimit. Gjithashtu, nisur nga modeli i vendit për rishikimin kushtetues dhe rolin plotësues të Gjykatës Kushtetuese ndaj gjykatave të zakonshme, mund të konsiderohet se në rrëzimin e ankimeve kushtetuese në çështjet në fjalë, Gjykata Kushtetuese në fakt kishte miratuar arsytet e dhëna nga gjykatat më të ulëta. Prandaj, proceset gjyqësore në fjalë nuk ishin bërë të padrejta nga mosdhënia e arsytimit shtesë nga Gjykata Kushtetuese.

2. Vlerësimi i Gjykatës

a) Aksesi në Gjykatën Kushtetuese

i. Parime të përgjithshme

α) Në lidhje me të drejtën për t'ju drejtuar një gjykate

50. Parimet përkatëse mbi të drejtën për t'ju drejtuar një gjykate dhe, në veçanti, për aksesin në gjykatat më të larta janë përmbledhur në Zubac kundër Kroacisë ([DHM], nr. 40160/12, §§ 76-99, 5 prill 2018). Gjykata përsërit se e drejta për t'ju drejtuar gjykatave mund t'i nënshtrohet kufizimeve, të cilat, sidoqoftë, mund të mos e kufizojnë aksesin që i lihet individit në atë mënyrë ose në atë masë që të shtrembërohet vetë thelbi i të drejtës. Gjithashtu, kufizimi nuk është në përputhje me

nenin 6 § 1 nëse nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme proporcionaliteti ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet (ibid. § 78). E drejta për t'ju drejtuar gjykatës cenohet kur rregullat nuk i shërbejnë më qëllimeve të sigurisë juridike dhe administrimit të duhur të drejtësisë, dhe krijojnë një lloj pengese ndaj palës ndërgjyqëse për marrjen e një vendimi mbi themelin e çështjes nga gjykata kompetente (*shihni Kart kundër Turqisë* [DHM], nr. 8917/05, § 79, GJEDNJ 2009, dhe *Arrozpide Sarasola dhe të tjerët kundër Spanjës*, nr. 65101/16 dhe 2 të tjera, § 98, 23 tetor 2018).

51. Neni 6 i Konventës nuk i detyron shtetet kontraktuese që të krijojnë gjykata apeli ose gjykata të tjera më të larta. Megjithatë, kur këto gjykata nuk ekzistojnë, duhet të respektohen garancitë e nenit 6, për shembull, palëve ndërgjyqëse duhet t'ju garantohet e drejta efektive e aksesit në gjykata për të vendosur mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre civile (shihni Zubac, cituar më lart, § 80). Këto garanci përfshijnë të drejtën që të merret një vendim përfundimtar mbi një çështje që i është paraqitur gjykatës, sidomos, ashtu si në këtë çështje, një vendim për pranueshmërinë dhe/ose themelin e ankimeve kushtetuese të tyre.

β) Përmbledhja e praktikës gjyqësore për votat e barabarta dhe kërkesën për shumicë të cilësuar

52. Gjykata ka trajtuar pyetjet ligjore përkatëse në tre çështje të mëparshme. Në çështjen *Marini* (cituar më lart, § 118), ankimi kushtetues i kërkuarit *u refuzua* përkohësisht nga trupi gjyqësor me shtatë anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, për shkak se gjykata nuk e arriti “shumicën e kërkuar të votave të të gjithë anëtarëve për ndonjë nga rezultatet” në shqyrtim. Në atë kohë, neni 133 § 2 i Kushtetutës parashikonte që Gjykata Kushtetuese “vendos me shumicën e të gjithë anëtarëve të saj”, pra me pesë vota. Neni 74 i ligjit për Gjykatën Kushtetuese parashikonte që në rastin e votave të barabarta, ose nëse “nuk krijohet shumica për ndonjë qëndrim”, kërkesa refuzohej përkohësisht dhe mund të paraqitej përsëri në të ardhmen. Tre gjyqtarë kishin bashkëngjitur një “mendim pakice” ku jepnin arsye pse, sipas tyre, vendimet gjyqësore të gjykatave më të ulëta shkelnin të drejtën e kërkuarit për një proces të drejtë. Për qëndrimin e shumicës nuk u dhanë arsye themelore, as detaje mbi mënyrën se si kishin votuar katër gjyqtarët e tjerë.

53. Në gjetjen e shkëljes për të drejtën e kërkuarit për t'ju drejtuar gjykatës në atë çështje, Gjykata theksoi se “ndryshe nga qëndrimi i mbajtur nga palët, Gjykata mund të konkludojë vetëm që Gjykata Kushtetuese nuk u shpreh për ankimin e kërkuarit jo për shkak të votave të barabarta, por për shkak të mungesës së shumicës për propozimet e paraqitura për diskutim. Duhet vërejtur që për këtë situatë nuk u dhanë arsye” (ibid. § 119). Për rrjedhojë, mosarritja e shumicës për pretendimet kushtetuese në fjalë në atë çështje e kishte lënë kërkuarin pa një vendim përfundimtar për çështjen e tij dhe në këto rrethana e kishte kufizuar thelbin e të drejtës së tij për t'ju drejtuar një gjykate (ibid. § 122).

54. Duke pranuar që çështja nuk kishte të bënte me vota të barabarta, Gjykata në çështjen *Marini* (të cituar më lart, § 123) vijoi të bëjë *obiter dictum*, si më poshtë:

Në ndryshim nga sistemet e tjera ligjore, të cilët ose e pengojnë mundësinë e ndarjes së votave ose sigurojnë alternativa të ndryshme për të bërë të mundur marrjen e një vendimi përfundimtar në rast se ndodh kjo ndarje, në sistemin ligjor shqiptar ndarja e votave në mënyrë të barabartë në Gjykatën Kushtetuese çon në marrjen e një vendimi, i cili formalisht nuk i jep zgjidhje çështjes në shqyrtim. Për më tepër, nuk jepen arsyet për rrëzimin e kërkesës në raste të tilla, përveçse që votat janë ndarë në mënyrë të barabartë. Duke marrë parasysh parashtrimet e saj të mësipërme, Gjykata mundet veçse të dalë në përfundimin se parashikimi për ndarjen e votave në mënyrë të barabartë në nenin 74 të LOGJK-së [ligji për organizimin e Gjykatës Kushtetuese] nuk i shërben sigurisë juridike dhe mund të privojë ankuesin nga e drejta efektive për një vendim përfundimtar për kërkesën e tij drejtuar Gjykatës Kushtetuese.”

55. Në *Andia dhe të tjerë kundër Bosnjë Hercegovinës*, (nr. 28357/11 dhe 2 të tjera, 19 nëntor 2013), Gjykata gjeti shkëlje të së drejtës së kërkuarve për t'ju drejtuar një gjykate për shkak të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese kombëtare, të mbledhur në trup gjyqësor me tetë dhe shtatë gjyqtarë, për të rrëzuar ankimet e kërkuarve për shkak të moskrijimit të shumicës me pesë anëtarë për ndonjë nga propozimet në shqyrtim. Në të gjitha çështjet, të gjitha mendimet e shprehura në diskutimet e

gjykatës ishin përfshirë në vendimet gjyqësore, të cilat ishin përfundimtare (ibid. §§ 8, 12 dhe 16). Sipas rregullave të gjykatës, të cilat ishin miratuar nga vetë Gjykata Kushtetuese, vendimet duhej të merreshin nga shumica e të gjithë anëtarëve të saj (pesë gjyqtarë). Gjithashtu, “nëse të paktën pesë gjyqtarë nuk votojnë njësoj për një projekt vendim mbi një ankim”, ankimi konsiderohet i refuzuar (ibid. § 35).

56. Gjykata, duke refuzuar argumentin e Qeverisë së paditur që çështja duhet të dallohet nga ajo *Marini*, gjeti se pavarësisht nga natyra përfundimtare e vendimeve, nuk pati “vendim përfundimtar” për themelin e ankimeve. Autoritetet kombëtare nuk kanë bërë përpjekje për të gjetur zgjidhje alternative për procedurat e Gjykatës Kushtetuese që mund të pengojnë këto rezultate.

57. Në *Loizides kundër Qipros* (nr. 31029/15, 5 korrik 2022), Gjykata vlerësoi ankimin e kërkuarit për shkelje të së drejtës së tij për t’ju drejtuar një gjykate në rrethanat ku Gjykata e Lartë kombëtare, e mbledhur në trup gjykues me dymbëdhjetë gjyqtarë, kishte refuzuar kërkesën e tij penale për shkak të votave të ndara në mënyrë të barabartë. Ishin dhënë tre “vendime gjyqësore” të veçanta, që përmbajnë arsyetimin e të gjithë dymbëdhjetë gjyqtarëve për themelin e çështjes (ibid., § 12). Legjislacioni kombëtar parashikonte që në rastin e votave të ndara në mënyrë të barabartë, vendimi gjyqësor duhej të jepej kundër palës që kishte mbajtur barrën e provës. Në një deklaratë të trupit gjykues pas dhënies së vendimeve gjyqësore, Kryetari i Gjykatës kishte sqaruar që, meqë barra e përmbysjes së dënimit ishte mbi kërkuarin, kërkesa ishte refuzuar (ibid., § 17). Më tej, Gjykata theksoi se, edhe pse çështja nuk ishte trajtuar me probleme kushtetuese, jurisprudenca kombëtare në çështje që përfshijnë kushtetutshmërinë e legjislacionit parësor kishte vendosur që votat e ndara në mënyrë të barabartë rezultonin në vendim në favor të një ligji të kundërshtuar sepse “prezumimi i kushtetutshmërisë së ligjeve nuk ishte i përmbysur” (ibid., § 30).

58. Në *Loizides* Gjykata konkludoi që nuk kishte shkelje të nenit 6. Kështu, ajo theksoi se nuk kishte interpretuar më përpara që votat e ndara në mënyrë të barabartë përbënin *per se* shkelje të nenit 6, dhe as nuk mund të gjente në rrethana që normat ligjore për efektet e votave të ndara në mënyrë të barabartë ishte në kundërshtim *per se* me nenin 6 (shihni *Loizides*, cituar më lart, § 43). Në vlerësimin nëse vendimet gjyqësore të dhëna ishin të arsyetuara mjaftueshëm për të lejuar kërkuarin që të kuptojë rezultatit e çështjes, Gjykata theksoi se ato përmbanin arsyet edhe për pranimin edhe për refuzimin e ankimit, me argumente të mjaftueshme. Duke pasur parasysh të gjitha këto, mungesa e arsyetimit në vendimet gjyqësore për funksionimin e normave ligjore mbi efektet e votave të ndara në mënyrë të barabartë, nuk përbën shkelje të të drejtave të kërkuarit sipas nenit 6 në atë çështje.

ii. Zbatimi i këtyre parimeve në çështjen në fjalë

59. Kërkesat në fjalë kanë të bëjnë me refuzimin e përhershëm të ankimeve përkatëse kushtetuese të kërkuarve si rezultat ose i votave të barabarta, ose i mungesës së shumicës së kërkuar prej pesë gjyqtarësh për gjetjen e një shkeljeje kushtetuese (shihni paragrafët 9 dhe 20 më sipër).

α) Vota e ndarë në mënyrë të barabartë dhe efektet e saj

60. Në lidhje me situatën e votave të ndara në mënyrë të barabartë, Gjykata më përpara është shprehur, në çështjen *Loizides* (cituar më lart, § 43), që votat e ndara në mënyrë të barabartë që rezultojnë në refuzimin e arsyetuar si duhet të një ankimi individual nuk mund të konsiderohen se shkelin të drejtën për t’ju drejtuar gjykatës, nëse pasojat e votave të ndara në mënyrë të barabartë për rezultatit e mosmarrëveshjes, janë mjaftueshëm të qarta dhe të sigurta sipas së drejtës kombëtare. Gjykata nuk sheh arsye për t’u shmangur nga ai interpretim i fundit. Në fushën e gjykimit kushtetues, në veçanti, kjo qasje mund të konsiderohet në përputhje me parimin e prezumimit të kushtetutshmërisë së ligjeve dhe akteve të tjera të qeverisë, kushtetutshmëria e të cilave kundërshtohet nga kërkuar të veçantë.

61. Më tej, Gjykata thekson në lidhje me Shqipërinë që, sipas vendimit të saj në çështjen *Marini* dhe si përgjigje të drejtpërdrejtë ndaj tij, rregullat që rregullojnë vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese kombëtare kanë ndryshuar në disa aspekte materiale. Së pari, nenit 133 § 2 i Kushtetutës u ndryshua për të parashikuar që “Gjykata Kushtetuese merr vendimet e saj me shumicën e të gjithë anëtarëve të saj, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj”.

Së dyti, kuorumi për çështjet e dëgjuara nga seanca plenare e Gjykatës Kushtetuese u vendos në “jo më pak se dy të tretat e të gjithë trupës gjyqësore”, pra, gjashtë gjyqtarë (shihni paragrafin 26 më sipër). Së treti, neni 73(4) i ligjit për Gjykatën Kushtetuese parashikon që “Kur nuk formohet shumica prej 5 gjyqtarësh, kërkesa konsiderohet e rrëzuar”.

Për rrjedhojë, votat e barabarta, ose çdo votë tjetër që nuk prodhon shumicën prej pesë gjyqtarësh për çdo ankim kushtetues, do të rezultojë në rrëzimin përfundimtar të ankimit (shihni paragrafin 29 më sipër). Prandaj Gjykata vlerëson se problemet e sigurisë juridike dhe mungesës së një “vendimi përfundimtar” të identifikuar në çështjen Marini nuk lindin në çështjet në fjalë. Është e qartë nga vendimet përkatëse të Gjykatës Kushtetuese se votat përfundimtare bëhen sipas vlerësimit të duhur të themelit të çdo ankimi nga seanca plenare, në përputhje me praktikën e saj normale.

β) Kërkesat e shumicës së cilësuar dhe efektet e saj

62. Ankimet për të drejtën për një vendim gjyqësor të arsyetuar (nga gjykatat më të ulëta) të paraqitura nga të dy kërkuarit u refuzuan nga Gjykata Kushtetuese sepse nuk u formua shumica me pesë gjyqtarë. Në të dyja çështjet, shumica e gjyqtarëve në formacionet përkatëse votoi në favor të rrëzimit të ankimeve.

63. Gjykata vëren se kërkesat për shumicë të cilësuar në gjykimin kushtetues nuk janë të pazakonta në traditën ligjore evropiane. Arsyet për këto qasje synojnë të rrjedhin, mes konsideratave të tjera, nga nevoja për të respektuar parimin e prezumimit të kushtetutshmërisë së akteve ose për të siguruar autoritetin normativ të vendimeve të tyre mbi çështje sensitive të së drejtës kushtetuese. Ashtu si me votat e ndara në mënyrë të barabartë, Gjykata vlerëson se kërkesa për shumicë të cilësuar nuk mund të shihet *per se* si e tillë që shkel të drejtën për t’ju drejtuar gjykatës sipas nenit 6 të Konventës.

64. Për t’ju kthyer çështjeve në fjalë, Gjykata vëren se kërkesa për shumicën me pesë gjyqtarë parashikohet në nenin 133 § 2 të Kushtetutës kombëtare. Neni 73(4) i ligjit për Gjykatën Kushtetuese, i plotësuar nga praktika e konsoliduar e Gjykatës Kushtetuese, e bën të qartë që në çështje ku nuk formohet shumica e kërkuar, çdo ankim kushtetues duhet të konsiderohet i rrëzuar përfundimisht, me efekt *res judicata*. Votat në çështjet e kërkuarve vijuan pas një diskutimi të plotë në seancë plenare për themelin e çdo ankimi, sipas praktikës së zakonshme. Rezultati i votave dhe pasojat e tyre për ankimet e kërkuarve, sipas nenit 73(4) të ligjit për Gjykatën Kushtetuese, ishin treguar qartë në secilin vendim. Në këto rrethana, Gjykata del në përfundimin që nuk mund të gjendet shkelje e të drejtës së kërkuarve për t’ju drejtuar gjykatës thjesht bazuar në zbatimin e nenit 73(4) të ligjit për Gjykatën Kushtetuese, të lexuar së bashku me nenin 133 § 2 të Kushtetutës, në çështjet e tyre.

65. Gjykata pranon se kërkesa për supershumicë, në rrethana të caktuara, mund të çojë në situata që mund të ngrenë pyetje më të vështira për aksesin në gjykatë. Kështu, në sistemin ligjor shqiptar funksionimi i kombinuar i kuorumit të seancës plenare të Gjykatës Kushtetuese (gjashtë gjyqtarë) dhe kërkesës për shumicë të cilësuar (pesë votat e nevojshme për të gjetur shkelje kushtetuese) mund të çojë në situata ku ankimet rrëzohen edhe nëse shumica e gjyqtarëve ka votuar pro ankimit individual (për shembull votimi 4–2 ose 4–3 në favor të pranimit të ankimit). Këto shqetësime mund të bëhen më akute në rrethana ku Gjykata Kushtetuese mund të veprojë për periudha të gjata kohore pa trup të plotë, siç ka ndodhur më përpara në Shqipëri pas reformave të vitit 2026 të sistemit të drejtësisë (shihni paragrafin 21 më lart) dhe ka vonesa në plotësimin e vendeve vakante në trupën gjyqësore. Në këto skenarë, individët që kërkojnë dëmshpërblim për shkeljet e pretenduara të të drejtave të tyre kushtetuese mund të përballen me probabilitet veçanërisht të vështirë për formimin e shumicës së kërkuar me pesë gjyqtarë në favor të tyre dhe përmbysjen e prezumimit të kushtetutshmërisë; për shembull, shumica me pesë nga gjashtë gjyqtarë do të nevojitet të ketë epërsi në një formacion me kuorumin minimal prej gjashtë gjyqtarësh.

66. Megjithatë, Gjykata thekson se kërkuarit në fjalë nuk parashtruan ndonjë argument të qartë përgjatë këtyre linjave. Në të dyja çështjet, shumica e Gjykatës Kushtetuese votoi në favor të

refuzimit të ankimeve të tyre, ndërsa për një ankim votat u ndanë në mënyrë të barabartë. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson që nuk kërkohet vlerësimi i mëtejshëm i këtyre pyetjeve.

γ) Konkluzion

67. Duke pasur parasysh konsideratat e shprehura më lart, Gjykata gjen që kërkuesve nuk u ishte privuar e drejta për vendimmarrje mbi themelin e pretendimeve të tyre. Dispozitat ligjore janë mjaftueshëm të qarta për rezultatin e ankimeve për të cilat nuk arrihet të formohet shumica me pesë vota, që do të thotë se vendimmarrja ka qenë e pa diskutueshme, duke garantuar kështu të drejtën për t'ju drejtuar Gjykatës Kushtetuese. Prandaj, Gjykata konkludon se në këtë çështje nuk mund të dallohet shkelje e të drejtës së kërkuesve për akses në gjykatë dhe se nuk ka pasur shkelje të paragrafit 1, të nenit 6 në këtë drejtim.

b) E drejta për vendim gjyqësor të arsyetuar

i. Parime të përgjithshme

68. Gjykata përsërit që sipas praktikës së saj të konsoliduar gjyqësore, që pasqyron një parim të lidhur me administrimin e duhur të drejtësisë, vendimet e gjykatave dhe tribunaleve duhet të shprehin në mënyrë adekuate arsytet mbi të cilat ato bazohen (shihni *Moreira Ferreira kundër Portugalisë* (nr. 2) [GC], nr. 19867/12, § 84, 11 korrik 2017). Masa për të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë sipas natyrës së vendimit dhe duhet të përcaktohet duke pasur parasysh rrethanat e çështjes (shihni *García Ruiz kundër Spanjës* [DHM], nr. 30544/96, § 26, GJEDNJ 1999 I, me referenca të mëtejshme, dhe *Ajdariæ kundër Kroacisë*, nr. 20883/09, § 34, 13 dhjetor 2011). Pa kërkuar një përgjigje të detajuar për çdo argument të paraqitur nga ankimesi, ky detyrim presupozon që palët në proces gjyqësor mund të presin të marrin një përgjigje specifike dhe të qartë për argumentet që janë vendimtare për rezultatin e atyre proceseve (shihni, mes vendimeve të tjera, *Ruiz Torija kundër Spanjës*, 9 dhjetor 1994, §§ 29–30, seria A nr. 303 A, dhe *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, 19 shkurt 1998, §§ 42–43, Reporte 1998 I).

69. Që të plotësohen kërkesat për proces gjyqësor të drejtë, palët dhe publiku duhet të jenë në gjendje të kuptojnë vendimin gjyqësor që është dhënë; kjo është garanci e rëndësishme kundër arbitraritetit. Siç e ka theksuar shpesh Gjykata, shteti i së drejtës dhe shmangia e fuqisë arbitrare janë parimet në themel të Konventës (shihni, mes shumë vendimeve të tjera, *mutatis mutandis*, *Roche kundër Mbretërisë së Bashkuar* [DHM], nr. 32555/96, § 116, GJEDNJ 2005-X, dhe *Taxquet kundër Belgjikës* [DHM], nr. 926/05, § 90, GJEDNJ 2010). Në sferën gjyqësore, këto parime, përfshirë arsyetimin e duhur të vendimeve gjyqësore, shërbejnë për të nxitur besimin e publikut në një sistem drejtësie objektiv dhe transparent, një nga themelet e shoqërisë demokratike (shihni *Suominen kundër Finlandës*, nr. 37801/97, § 37, 1 korrik 2003, dhe *Tatishvili kundër Rusisë*, nr. 1509/02, § 58, GJEDNJ 2007-I).

ii. Zbatimi i këtyre parimeve në çështjen në fjalë

70. Në këtë çështje, Gjykata është vënë në lëvizje për të vlerësuar argumentet e kërkuesve në lidhje me mosdhënien e arsyeve adekuate nga Gjykata Kushtetuese për refuzimin e ankimeve të tyre kushtetuese.

71. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se vendimet përkatëse kufizoheshin me vënien në dukje të rezultatit të votimit dhe rezultatit përfundimtar, përfshirë një të dhënë të shkurtër në shënimin fundor për mënyrën e votimit nga secili gjyqtar (shihni paragrafët 13 dhe 20 më lart). Ato nuk dhanë arsye për themelin e çështjes dhe nuk dhanë mendimet e shumicës efektive (pra, gjyqtarët që votuan për të refuzuar ankimet) apo ato të pakicës efektive (gjyqtarët që votuan në favor të pranimit të ankimeve). Për rrjedhojë, kërkuesit kishin siguri për refuzimin përfundimtar të ankimeve të tyre, por jo për arsytet dhe shkaqet thelbësore mbi të cilat Gjykata Kushtetuese kishte dalë në ato konkluzione.

72. Gjykata vëren se ligji për Gjykatën Kushtetuese parashikon që vendimet e gjykatës duhet “të shpallen të arsyetuara” (shihni paragrafin 28 më lart), edhe pse nuk e specifikon masën e arsyetimit, nëse ka, që duhet të bëhet kur një çështje rrëzohet për shkak se nuk arrihet shumica e kërkuar. Rrjedhimisht, përmbushja nga Gjykata Kushtetuese e detyrimit për të dhënë vendime

gjyqësore të arsyetuara në mënyrë adekuate duhet të vlerësohet fillimisht në bazë të praktikës së vetë asaj gjykate, dhe jo të dispozitave specifike në kuadrin ligjor ekzistues.

73. Gjykata më përpara në çështjen *Marini* (cituar më lart, § 105) ka theksuar se e drejta që i garantohet një pale sipas nenit 6 të Konventës përfshin të drejtën që gjykatat e brendshme t'i japin arsytet për vendimin në çështjen e tyre. Ndryshe nga vendimet gjyqësore të brendshme në çështjen *Loizides* (cituar më lart, § 45), i cili përmbante arsye të plota për lejimin ose refuzimin e ankimit me argumente të mjaftueshme, në këtë çështje Gjykata Kushtetuese, në fakt, refuzoi të japë ndonjë argument për themelin e ankimeve. Gjykata nuk është në gjendje të pranojë argumentin e Qeverisë që në këtë situatë Gjykata Kushtetuese duhet të konsiderohet se ka miratuar arsyetimin e gjykatave më të ulëta - sidomos kur ankimet e kërkuessve kishin të bënin pikërisht me cilësinë e arsyetimit të gjykatave të zakonshme ose respektimin prej tyre të garancive për procesin gjyqësor të drejtë. Kjo qasje do të ishte veçanërisht problematike në një sistem të rishikimit kushtetues të centralizuar si ai i Shqipërisë.

74. Gjykata duhet të ketë parasysh se gjykatat kanë detyrimin të ndërmarrin një shqyrtim të duhur dhe t'i përgjigjen kërkesave kryesore të ngritura nga një palë në proces (shihni, *mutatis mutandis*, *Donadze kundër Gjeorgjisë*, nr. 74644/01, § 35, 7 mars 2006). Nëse, përveç kësaj, ato kërkesa kanë të bëjnë me “të drejta dhe liri” të garantuara nga Konventa dhe Protokollet e saj, gjykatat kombëtare duhet t'i shqyrtojnë ato me rreptësi dhe kujdes të veçantë (shihni *Wagner dhe J.M.W.L. kundër Luksemburgut*, nr. 76240/01, § 96, 28 qershor 2007). Kështu nga këndvështrimi i subsidiaritetit, mosdhënia e arsyetimit nga Gjykata Kushtetuese në çështjet në fjalë pengon Gjykatën në vlerësimin e respektimit të Konventës për përcaktimin e pretendimeve thelbësore të kërkuessve sipas Konventës (shihni edhe konsideratat në paragrafin 69 më lart).

75. Në këtë kontekst, Gjykata nuk mund të mos theksojë edhe evoluimin më të fundit në praktikën e Gjykatës Kushtetuese kombëtare, sidomos për dhënien të paktën të një arsytimi të përmbledhur të qëndrimeve të shumicës dhe pakicës efektive në çështje me rezultat të njëjtë me ato të kërkuessve në fjalë (shihni paragrafin 31 më lart). Megjithatë, qëndron fakti që në këto çështje nuk janë dhënë këto arsye.

76. Edhe pse kërkuessit në të dyja çështjet morën një vendim përfundimtar për ankimet e tyre nga Gjykata Kushtetuese, atyre nuk ju dhanë shkaqe ligjore përkatëse për refuzimin e kërkesave të tyre. Kjo mungesë e arsyetimit adekuat nuk plotësoi kërkesat për proces gjyqësor të drejtë. Prandaj, në këto rrethana konstatohet shkelje e paragrafit 1, të nenit 6 të Konventës.

III. SHKELJE TË TJERA TË PRETENDUARA TË KONVENTËS

77. Kërkuessit, gjithashtu, u ankuan sipas nenit 6 § 1 të Konventës për arsyetimin e gjykatave të zakonshme që trajtuan çështjet e tyre dhe kërkuessit (në kërkesën nr. 41373/21) më tej u ankuan për shkeljen e pretenduar të barazisë së armëve.

78. Duke pasur parasysh gjetjen e saj në lidhje me të drejtën e kërkuessve për një vendim gjyqësor të arsyetuar sipas nenit 6 § 1 të Konventës (shihni paragrafin 76 më lart), Gjykata thekson se tani kërkuessit kanë mundësi të kërkojnë rihapjen e proceseve të tyre përkatëse përpara Gjykatës Kushtetuese (shihni paragrafin 83 më poshtë), e cila aktualisht ka trupë gjyqësore të plotë me nëntë gjyqtarë. Në parim kjo mundëson shqyrtimin e ankimeve të mbetura të kërkuessve sipas Konventës përmes një vendimi të arsyetuar si duhet të asaj gjykate. Në këto rrethana dhe në përputhje me rolin e saj plotësues, Gjykata vlerëson se nuk është e nevojshme të shqyrtohen ankimet e mbetura të kërkuessve në këtë moment. Për ata është e hapur mundësia që të depozitojnë kërkesa të reja në Gjykatë, sipas rastit, pas vendimmarrjes më të fundit për ankimin e tyre kushtetues në nivel kombëtar.

IV. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

79. Neni 41 i Konventës lexon:

“Kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj dhe, nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar”.

A. Dëmi

80. Kërkuesi kërkoi 6.480.000 euro (EUR) për dëmin pasuror dhe 60.000 euro për dëmin jopasuror.

81. Shoqëria kërkuese kërkoi 15.000 EUR për dëmin jopasuror.

82. Qeveria gjykon që shumat e pretenduara janë të pabazuara dhe të tepruara.

83. Gjykata përsërit që një vendim gjyqësor ku ajo gjen shkelje të Konventës vendos ndaj shtetit të paditur detyrimin ligjor për t'i dhënë fund shkeljes dhe për të korrigjuar pasojat e saj. Nisur nga natyra e ankimeve të kërkuesve dhe të shkeljeve të gjetura, Gjykata përsërit, ashtu siç ka bërë në shumë çështje të mëparshme ku ka gjetur që proceset e brendshme gjyqësore kanë shkelur Konventën, se forma më e përshtatshme e dëmshpërblimit për shkeljet e gjetura do të ishte rihapja e proceseve gjyqësore të brendshme (krahasoni *Sevdari kundër Shqipërisë*, nr. 40662/19, §§ 144–45, 13 dhjetor 2022). Në këtë drejtim, Gjykata vëren që neni 71(c) i ligjit për Gjykatën Kushtetuese parashikon që proceset në Gjykatën Kushtetuese mund të rihapen nëse një gjykatë ndërkombëtare, juridiksioni i të cilës shtrihet në Republikën e Shqipërisë konstaton se janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore të një personi “për shkak të një vendimi [të mëparshëm] të Gjykatës Kushtetuese”.

84. Gjykata nuk dallon ndonjë lidhje shkakësore ndërmjet shkeljes së gjetur dhe dëmit pasuror të pretenduar nga kërkuesi. Prandaj ajo e refuzon këtë pretendim. Nga ana tjetër, Gjykata vlerëson se kërkuesit mund të kenë pësuar dëm jopasuror si rezultat i shkeljes së gjetur. Duke e bërë vlerësimin e saj mbi baza të barabarta, siç e kërkon neni 41 i Konventës, ajo i cakton çdo kërkuesi 3.600 EUR për dëmin jopasuror.

B. Kosto dhe shpenzime

85. Kërkuesi kërkoi 6.000 euro për kostot dhe shpenzimet e bëra para gjykatave të brendshme dhe 3.000 euro për ato të bëra përpara Gjykatës.

86. Shoqëria kërkuese kërkoi 61.164 euro për kostot dhe shpenzimet e bëra para gjykatave të brendshme dhe 12.960 euro për ato të bëra përpara Gjykatës.

87. Qeveria i kundërshtoi këto kërkesa.

88. Sipas jurisprudencës së Gjykatës, një kërkues ka të drejtën e rimbursimit të kostove dhe shpenzimeve vetëm për atë që provohet se ato janë bërë realisht dhe domosdoshmërisht dhe janë të arsyeshme sa i përket shumës. Në këtë çështje, duke pasur parasysh dokumentet në posedim dhe kriteret më sipër, Gjykata e vlerëson të arsyeshme të caktojë për kërkuesin shumën 4.000 EUR dhe për shoqërinë kërkuese shumën 6.000 EUR për mbulimin e kostove të kryera përpara Gjykatës dhe Gjykatës Kushtetuese, plus çdo taksë që mund t'ju ngarkohet atyre.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, UNANIMISHT

1. *vendos* të bashkojë kërkesat;

2. *shpall* të papranueshëm ankimin e kërkuesit në kërkesën nr. 41373/21 për kohëzgjatjen e procesit gjyqësor përpara Gjykatës Kushtetuese;

3. *shpall* të pranueshme ankimet e kërkuesve sipas nenit 6 § 1 të Konventës, në lidhje me të drejtën për t'ju drejtuar Gjykatës Kushtetuese dhe të drejtën për një vendim të arsyetuar nga Gjykata Kushtetuese;

4. *vendos* që nuk ka shkelje të paragrafit 1, nenit 6 të Konventës për mungesën e pretenduar të aksesit në Gjykatën Kushtetuese;

5. *vendos* që është shkelur paragrafi 1, i nenit 6 të Konventës, për të drejtën e kërkuesve për një vendim të arsyetuar nga Gjykata Kushtetuese;

6. *vendos* që nuk ka nevojë të shqyrtojë ankimet e tjera sipas paragrafit 1, të nenit 6 të Konventës;

7. *Vendos*

a) që shteti i paditur t'i paguajë kërkuesve, brenda tre muajve nga data në të cilën vendimi merr formë të prerë, në përputhje me paragrafin 2, të nenit 44 të Konventës, shumat e mëposhtme që do të konvertohen në monedhën e shtetit të paditur me kursin e këmbimit në fuqi në datën e shlyerjes:

i. 3.600 (tre mijë e gjashtë qind euro) EUR, për çdo kërkues për dëmin jopasuror, plus çdo taksë që mund t'ju ngarkohet;

ii. 4.000 (katër mijë euro) EUR për kërkuesin për kostot dhe shpenzimet, plus çdo taksë që mund t'i ngarkohet;

iii. 6.000 (gjashtë mijë euro) EUR për shoqërinë kërkuese për kostot dhe shpenzimet, plus çdo taksë që mund t'i ngarkohet asaj;

b) nga mbarimi i afatit tremujor të sipërpërmendur deri në shlyerje, interes i thjeshtë të paguhet për shumat e mësipërme sipas normës të njëjtë me normën marxhinale të kreditimit të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagimit plus tre pikë përqindje;

8. *rrëzoh* pjesën tjetër të pretendimeve të kërkuesve për kompensim të drejtë.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 16 korrik 2024 sipas Rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Milan Blaško
KANCELAR

Pere Pastor Vilanova
KRYETAR